



PRISHTINA




# RAPORTI I PUNËS SË KRYEQYTETIT

*KY RAPORT PASQYRON TË  
ARRITURAT E EKIPIT TË KRYEQYTETIT*

2023





*Të dashur qytetarë,*

Kemi përmbyllur një vit me shumë punë të kryera, me rezultate të prekshme e me shume projekte të reja.

Sfidat e vazhdueshme nuk na e zbehin asnjëherë përkushtimin dhe entuziazmin për t'i realizu të gjitha projektet e domosdoshme për kryeqytetin tonë.

***Sot Prishtina nuk është më ajo e para dy viteve.***

## PËRMBAJTJA

**RRUGËT 4**

**NDRIÇIMI PUBLIK 10**

**NGROHJA QENDRORE 12**

**SHKOLLAT 16**

**SHËNDETËSIA 22**

**SPORTI 28**

**KULTURA 32**

**PARQET DHE GJELBËRIMI 36**

*(Shërbimet Publike)*





# RRUGËT



Sivjet nisëm dhe i vazhduam punimet me intensitet të lartë në rrugën **“Jim Xhema”** (rruga A). Ky projekt madhor infrastrukturor do ta lidhë **Prishtinën e Re** me Kalabrinë, dhe e ka zgjidhë tashmë problemin shumëvjeçar të kanalizimit të hapur në këtë zonë.





- I nisëm edhe punimet për vazhdimin e rrugës B në pjesën e poshtme të saj, që të lidhet me rrugën “Jim Xhema”, duke e shkarku dukshëm trafikun në qytet.
- Përfunduam asfaltimin e rrugës “Nekibe Kelmendi”, ndër më të rëndësishmet për zhvillimin e Prishtinës së Re.

Rrugët **“Agron Rama”**; **“Eva Mbrendli”**; **“Bedri Dedja”** dhe **“Zejnullah Halili”** në fshatin Shkabaj janë investime të tjera drejt transformimit të infrastrukturës rrugore në kryeqytet dhe zvogëlimit të trafikut nëpër rrugët e ngarkuara.



- Në Barilevë përfunduam ndërtimin e urës së re.
- U ndërtua edhe rruga që lidh fshatrat e Gollakut me Dardanën nëpërmjet rrugës Viti - Bullaj.

Po ndërtohet rruga në lagjen **“Gërbeshi”** dhe rruga **“Gjergj Balsha”** në lagjen Arbëria. Rruga që lidh fshatrat Stallovë e Zllash, rruga në Zllatar, në lagjen Kullaj të Mramorit, rruga e re në Butovc, në Koliq, në Prapashticë, Rruga “Qëndresa” në Matiçan,





Rruga në Lagjen Gërbeshi, Rruga e re në Hajvali, Rruga që lidh Prishtinën me Artanën, segmenti Flotacion – Klllokoq, Rruga e re në Ballaban, të gjitha këto iu shtuan infrastrukturës rrugore gjatë këtij viti.

- Janë në zhvillim punimet për rrugën që do të shfrytëzohet si bypass për kalimin nga rruga Ahmet Krasniqi në lagjen e Arbërisë së Re.
- E përfunduar asfaltimin e rrugës të Stacioni i Autobusëve, mes Kalabrisë e Dardanisë, që dukshëm po e liron e trafikun në këtë pjesë.
- Përfundoi edhe asfaltimi i parkingut “2 korriku” te Parku i Lagjes “Arbëria”.

- Zgjeruam rrugën “Ukshin Hoti” që çliron dukshëm rrjedhën e trafikut nëpër qendrën e qytetit.

Këto janë vetëm disa nga shumë projektet infrastrukturore nëpër qytet dhe fshatra, që synojnë t’i përmirësojnë lidhjet mes pjesëve të qytetit, ta lehtësojnë trafikun dhe të përmirësojnë vazhdimisht infrastrukturën, duke reflektuar angazhimin tonë për të krijuar një mjedis urban më të qasshëm dhe me efikas.





# NDRIÇIMI PUBLIK



E ndriçuem dhe po e ndriçojmë më tej kryeqytetin në çdo cep, me sistemin **Smart**, duke e zgjeruar rrjetin e ndriçimit publik.

Vetëm në Kodrën e Trimave për herë të parë u ndriçuan **15 rrugë** e rrugica të reja. Projekti përfshin mbi **100 rrugë** që nuk kanë pasë asnjëherë ndriçim publik.

Pas më shumë se 40 vjetësh shkallët te Posta e Madhe u renovuan tërësisht. Ia shtuam gjobërimin dhe e ndriçuem gjithë zonën.





# NGROHJA QENDRORE



Ngrohtorja e qytetit ka vazhduar punimet me intensitet të lartë, duke zgjeruar vazhdimisht rrjetin dhe duke ofruar shërbimet për mbi **20 mijë konsumatorë.**





34

U kyçën në rrjetin e ngrohjes 34 objekte të reja në lagjen Arbëria

- U siguroam që të mos i shtrenjojmë tarifat e ngrohjes qendrore, e që ajo të mbetet alternativa më e lirë, më e lehtë dhe më cilësore për ngrohje.
- U rehabilitua sistemi i tubacionit të ngrohjes në Lagjen Ulpiana – gypat e vjetëruar u zëvendësuan me gypa të paraizoluar të standardeve më të larta ndërkombëtare.
- Vetëm muajin e kaluar ndamë edhe 5 milion euro për zgjerim të mëtejshëm të rrjetit në 129 objekte të reja.
- Ndër të parat, ngrohje do të përfitojë kazerma “Adem Jashari”, kompleksi i “Ndërtesave të bardha” me gjithsej 1150 banesa, ndërtesat në “Lakrishte”, shkollat, xhamitë, kopshtet, etj.



230

Kurse në lagjen “Lakrishte” përfitojnë edhe 230 familje të reja.

- Veç kësaj, Prishtina po e transformon sistemin e ngrohjes qendrore përmes energjisë diellore. Me partnerët tanë të KfW, nënshkruam para pak kohësh Marrëveshjen për projektin më të madh në rajon – Solar 4 Kosovo, nëpërmjet të cilit do të kontribuojmë në ngritjen e kapacitetit ekzistues të furnizimit me ngrohje, i cili do të jetë më eficient, më i sigurt dhe më miqësor ndaj mjedisit.

Angazhimi ynë i vazhdueshëm për zgjerimin, përmirësimin dhe përtëritjen e infrastrukturës së ngrohjes qendrore të Prishtinës pasqyron përkushtimin tonë për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme, të përballeshme për xhepin e qytetarëve tanë dhe miqësore ndaj mjedisit.





# SHKOLLAT

Qysh në shkurt sivjet vumë gurthemelin për ndërtimin e objektit të ri të **Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore**, një projekt që po ec mjaft shpejt e që pritet të hyjë në funksion vitin e ardhshëm.





- Shkolla "Hoxhë Kadri Prishtina" u renovua për të parën here mbas shumë vitesh.
- Kanë filluar ndërtimet për aneksin e çerdhes në shkollën "Ar-dhmëria".

Dhe së shpejti do të përfundojnë punimet edhe në aneksin e shkollës "Pavarësia"

- Gjithashtu renovimet vazhdojnë në shkollat, "Naim Frashëri," "Meto Bajraktari", "Ahmet Gashi", "Gjergj Fishta", dhe "Dr. Ali Sokoli".



- Shkolla "Shtatë Shtatori" po bëhet me objekt të ri ??
- Me partneritet publiko-privat, po ndërtojmë shkollën në Lagjen 'Qëndresa', në lagjen Mati 1, dhe në Sofali ?

Bashkë me International Finance Corporation nënshkruam marrëveshjen për ndërtimin e pesë shkollave të reja për fëmijët tanë në lagjet Arbëri, Veternik, Kalabri e Qendër.

- Ndamë parcelat për ndërtimin e dy çerdheve në fshatrat Busi dhe Llukar.





- Edhe lagjes Dardania po i shtohet një çerdhe e re.
- Me organizatën “Save the Children” hapëm qendrën e parë të fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeçarë në fshatin Barilevë.
- Përfunduam ndriçimin, të jashtëm dhe të brendshëm, në Shkollën “Mehmet Gjevori”, “Xhavit Ahmeti” “Xhemail Mustafa”, si dhe në shkollën “Pavarësia”.
- Renovuam nyjet sanitare në shkollën “Afrim Gashi” në Hajvali.
- Shkolla duhet të ketë ambiente të sigurta e higjienike për nxënësit, prandaj, po investojmë në çdo shkollë që fëmijët e Prishtinës të ndihen sa më komodë.

## 24/7

Shkollat dhe çerdhet kanë tashmë në dispozicion Mjeshtrin e Shkollës – ekipin tonë mobil, të disponueshëm 24/7 për të gjitha rregullimet që u nevojiten.

- Po ashtu, 135 familjeve me të ardhura mujore nën 500 euro u mundësua t'i përfshijnë fëmijët në institucionet parashkollore private nëpërmjet subvencionimit prej 70 eurosh në muaj për çdo fëmijë.

Gjithë përkushtimin e palëkundshëm për arsimin e komunitetit tonë e bëjmë me qëllim që të dëshmojmë ndikimin pozitiv të këtyre iniciativave, ndërsa vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme më të ndritshme për fëmijët tanë.







QENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE  
VETERNIK

# SHËNDE- TËSIA



Inaguruam një Qendër të re të **Mjekësisë Familjare në Veternik**, e cila ofron edhe shërbimin urgjent.





## 1.3 MILIONË EURO

Sivjet prezantuar planin e detajuar për Spitalin Gjeneral të Prishtinës, për të cilin ndamë parcelën në Prishtinën e Re dhe një buxhet prej 1.3 milionë eurosh.

- QMF-ja e renovuar në Bardhosh u bë me Laborator për here të parë!
- Përfunduan renovimet në QMF-të në Velani, Hajvali, Mati 1, dhe QMF 11.
- Po vazhdojnë me intensitet të lartë renovimet në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kodrën e Trimave.
- Shërbimet laboratorike për hormone të gjëndrës tiroide i rritëm për 100 për qind dhe me mbi 40 për qind ato për diabetin.



- Siguroam aparatura mjekësore me kosto prej afro 300 mijë eurove, në mënyrë që qytetarët të marrin sa më shumë shërbime në sektorin primar, duke përfshi edhe ultrazërin, pa pasur nevojë të shkojnë në nivelin sekondar ose terciar. Filluam sivjet programin "Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0 deri në 3 vjeç", një hap tejet i rëndësishëm ky për ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor.
- Në Qendrën për Mirëqenien e Gruas, hapëm qendrën informuese për shëndetin e gruas, ku përmes terapisë grupore dhe këshillimit nga profesionistët, gratë shkëmbejnë përvojat për një shtatzëni sa më të shëndetshme.


## 5 KOMUNA

Ofruam Mamografi Falas gjatë muajit tetor, për grate në kryeqytet di dhe nga 5 komuna të tjera, duke thyer rekorde me numrin më të lartë të mamografive të realizuara ndonjëherë në vend.





- Në vështrimin tonë, sektorët e zhvillimit të kryeqytetit i shohim të ndërlidhur, prandaj për ne shëndetësia fillon me mënyrën se si jetojmë, me ofertat që kanë fëmijët tanë nëpër kopshte e shkolla, sa kemi mundësi për rekreacion, d.m.th ajo lidhet me sportin, me arsimin, e me qasjen në zonat e gjelbra.
- Përpjekjet tona pasqyrojnë përkushtimin që kemi për kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës dhe qasje tërësore ndaj mirëqenies.
- Ndërsa parashikojmë një të ardhme ku shëndeti është i integruar në çdo aspekt të jetës, ne mbetemi të përkushtuar që të ofrojmë kujdes cilësor, të nxisim një mënyrë jetese të shëndetshme dhe të garantojmë mirëqenien e brezave të sotëm dhe të ardhshëm në kryeqytetin tonë.







# SPORTI



Në shtator sivjet, në Kretë të Greqisë, me një vendim historik të Komitetit Ndërkombëtar të **Lojërave Mesdhetare**, Prishtina u zgjodh vendi mikpritës i Lojërave Mesdhetare për vitin 2030, duke u bërë i pari qytet jobregdetar që do t'i organizojë ato.





- Vetëm para pak javësh, Prishtina e mori titullin Qytet Evropian i Sportit për vitin 2024, nga organizata ACES Europe, në Parlamentin Evropian në Bruksel. Ky titull, ndër shumë avantazhe të tjera, na mundëson edhe të sigurojmë grante të BE-së për projekte në fushën e sportit, çka më tej ndihmon përkushtimin tonë për ta bërë sportin segment të rëndësishëm të jetës në kryeqytet.
- Me Klubin e Pingpongut organizuam Turneun Ndërkombëtar në të cilin garuan mbi 150 pjesëmarrës nga 10 shtete të ndryshme.
- Mbeshtetëm garat ndërkombëtare në basketboll 3X3, në të cilat garuan basketbolistë nga 14 shtete dhe krijuan atmosferë të jashtëzakonshme në kryeqytet.

- Mbajtëm një mbrëmje madhëshore të boksit profesional ndërkombëtar, duke e sjellë kampionin Robin Krasniqi për herë të parë në Prishtinë.
- Nga ana e infrastrukturës, renovuam fushën sportive të shkollës 9-vjeçare "Dardania",
- Fushën e re sportive pranë shkollës Zenel Hajdini, dhe Emin Duraku.
- Fusha e jashtme në Lakrishte
- Super Park i Sportit dhe rekreacionit në Prugovc.
- Fusha e basketit në Parkun e Gërmisë
- Fusha e re afër shkollës "Isamil Qemali" dy fusha të jashtme sportive në lagjen Kodra e Trimave,
- Ndërtuam fushën e jashtme sportive në lagjen "Vreshta".
- Renovuam edhe shtegun për vrapim në parkun e Taukbahçes.



Arritjet e Prishtinës në sport dhe zhvillimet në infrastrukturë për rekreacion sivjet hapin shtegun për një të ardhme të gjallërishe dhe aktive. Jemi të përkushtuar për ta bërë qytetin një vend të mrekullueshëm për sport, shëndet dhe mirëqenie të komunitetit.







# KULTURA

---



Nisëm rigjenerimin e **Sallës së Pallatit të Rinisë**, të lënë mbas dore për dy dekada, ku për here të pare u mbajt Festivali i Këngës i RTK-së.



- Jemi gati me rivitalizimin e rrugës “Mehmet Kaçurri” e cila po merr pamje fantastike dhe do të shërbej si shembull për rigjenerimin e blloqeve tjera brenda Qendrës Historike të Prishtinës.
- E ndërtuar në vitin 1979, dega e Bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në fshatin Llukar, shumë shpejtë do të jetë plotësisht e renovuar e gatshme për t’i pritur në një ambient të bukur fëmijët.
- Festivali Ylberi i Prishtinës mbledhi fëmijë nga e gjithë bota

■ Si çdo vit **Kryeqyteti** edhe sivjet mbështeti **FESTIVALET** e Chopin Fest, Fem Art, Festivalin e Gastronomisë, Festivalin e Operas Ramë Lahaj & Friends, Festivalin e Pranverës në rrugën Xhorxh Bush, festivalin e Korrikut e të tjerë.

- Kemi mbështetur PANAIRIN E LIBRIT 2023 në Prishtinës. Panari sjell bashkë autorë, botues dhe lexues në një ambient frymëzues, duke krijuar një platformë të shkëlqyeshme për përhapjen e dijes.
- “Meeting of Styles”, festivalin e grafitëve në “Rruga “B”, i cili e gjallëron me ngjyrat e shumta e muralet e bukura të artistëve nga vende të ndryshme të botës.
- Ndër projektet e shumta sivjet, pas 10 vjetësh, investuam në pishinën e Gërmisë dhe ajo sot e ka shtratin të lyer, amfiteaterin, terrenet sportive dhe toaletet e renovuara, me shtretër relaksi, gjelbërim të shtuar e kënde ushqimi.
- Po punojmë me renovimin dhe kemi arritë një marrëveshje me ngrahoren, sepse gjatë dimrit, duhen kushte optimale për aktivitete në Pallat. Pra, salla po u kthehet artistëve, sportistëve, të rinjve, do me thënë atyre që u takon.



**Zonës së vjetër** të Prishtinës po i kthehet identiteti.



# PARQET DHE GJELBËRIMI

*(Shërbimet Publike)*




I kemi liruar e po vazhdojmë ti  
**lirojmë hapësirat** publike të  
uzurpuara në kryeqytet.





- Pastruam nga mbeturint inerte dhe e gjelbëruam gjithë hapësirën afër Stacionit të Trenit, në rrugën "Tirana".
- Kemi hequr një deponi të madhe mbeturinash nga zona të Skkolla e Mesme "Xhevdet Doda".
- Hoqëm deponitë ilegale dhe rivitalizua hapësirat publike në hyrje të QKUK-së.

Edhe hapësira publike prapa ish shtëpisë së mallrave "**Gërmia**", dikur e mbushur me kontejnerë, tashmë po gjelbërohet.



- Po i japim një pamje krejt të re hyrjes së Prishtinës nga Gollaku, ku po zgjerohet profili i tërësishëm i rrugës, me gjelbërim, shteg të bicikletave e trotuare në të dy anët e rrugës.
- Parku rekreativ në "Kodrën e Trimave" ka përfunduar dhe është tashmë në dispozicion të fëmijëve të lagjes.

Kryeqytetit i janë shtuar dy kënde lojërash të **qasshme edhe për fëmijët** me aftësi të kufizuara. Qasja e barabartë për të gjithë qytetarët është prioritet i yni!





- Kemi nisur tashmë procedurat për realizimin e projektit të Tregut të ri të Gjelbër, për ta transformuar në një treg bashkëkohor.

Finalizuar punimet te dy Rrathët e Flamurit dhe te Rrethi i Hyjneshës. U vendosën flamuj të rinj dhe statuja e Hyjneshës në Fron.

- Në të trija hapësira u kujdesëm për të përfshirë gjithë infrastrukturën shoqëruese. Rretheqark tyre u rindërtua komplet rrjeti i ndriçimit të mençur dhe shenjzimi horizontal.
- Përuruar parkun në lagjen "Arbëria" me emrin e mikut të madh të Kosovës, ish-kryeministrit japonez, Shinzo Abe.

- Në ndërtim është edhe parku në Drenoc, me shtigje për ecje, kënde lojrash, hapësira fitnesi e drunj dekorativë dhe frutorë.

Përuruar parkun e ri në rrugën "Sylejman Vokshi", në lagjen Mati 1, Parkun Linear te Lagja e Spitalit, në Kodrën e Trimave.

- Rregulluar hapësirën publike në Kodrën e Diellit te parkingu i rrugës "Elez Geci".
- Tregu i drunjve, Tregu i veturave dhe poligoni i autoshkollave, të gjitha këto janë tashmë në një lokacion të përbashkët,
- Përpjekjet tona për t'i rikthyer dhe përmirësuar hapësirat publike të Prishtinës pasqyrojnë angazhimin tonë për një qytet më të gjelbër, më të pastër dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

Është hera e parë që kryeqytetin po e pajisim me biçikleta publike që qytetarët do të mund t'i marrin në një stacion, t'i përdorin e t'i dorëzojnë mandej në stacionin tjetër.





[prishtinaonline.com](http://prishtinaonline.com)

